



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2867/12 Prot.

Pogradec, më 27.07.2023

VENDIM

NR. 70, DATË 26.07.2023

PËR
MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE PËR MARRJEN ME QERA, SIPËRFAQE TOKE/TRUALL
PËR QËLLIME MAGAZINIMI DHE SHËRBIMI, PËR NEVOJAT E
BASHKISË POGRADEC DHE NDERMARRJEVE NË VARËSI TË SAJ.

Në mbështetje të; shkronjave "a" dhe "c" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjës "k" dhe shkronjës "n" të nenit 54 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 7 të Ligjit Nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe bazuar në relacionin i paraqitur, me propozim të Kryetarit të Bashkisë..

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :

1. Të miratojë normat, kriteret, rregullat dhe procedurat për marrjen sipërfaqe toke bujqesore/truall, për qëllime shërbimi, ruajtje, grumbullimi dhe magazinimi të aktiveve, për nevojat e Bashkisë Pogradec dhe Ndermarrjeve në varësi të saj.
2. Sipërfaqja tokë bujqesore ose truall që mund të merret me qira, të jetë jo më pak se 1400 (njëmijë e katërqind) m² dhe jo më shumë se 2000 (dy mijë) m² dhe jo më pak se 200 m² (dy qind) dhe jo më shumë se 300 m² (treqind) ndërtesa brenda së cilës të jetë edhe një objekt i cili do të shërbejë për ruajtjen e pjesëve të këmbimit, vajit si dhe materialeve të ndryshme për automjetet.
3. Vlera e qirase mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurimit të përcaktohet sipas VKM nr.469 date. 03.06.2015 për përcaktimi e vlerës minimale të cmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore.
4. Procedura e konkurimit për marrjen e sipërfaqes dhe objektit me qera, t'i nënshtrohet hapave të mëposhtëme:



4.1 Struktura e posacme e krijuar me urdher të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, të hartojë dhe të publikojë njoftimin për zhvillimin e procedurës së konkurrimit në buletin e publikimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në këndin e publikimeve pranë Bashkisë Pogradec.

4.2 Afati i paraqitjes së ofertave të zgjasë të paktën 10 (Dhjetë) ditë që nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së.

4.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, brenda 5 (Pesë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të shqyrtojë ofertat e kualifikuara si të rregullta dhe të vlerësojë me çmim më të ulët ofertën/ofertat, dhe të hartojë vendimin për renditjen e ofertueseve.

4.4 Subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, t'iu njihet e drejta të ankohen, me shkrim, pranë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 7 (Shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

4.5 Në përfundim të afateve të ushtrimit të së drejtës së ankimimit, kryetari i K.V.O i paraqet Kryetarit, një raport përmbledhës dhe i propozon për miratimin e fituesit të procedurës konkurruese.

4.6 Në përfundim të hapave të mësipërme, autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për nënshkrimin e kontratës së qirasë.

5. Kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë deri në 5 vjet.

6. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, Administrata e Bashkisë Pogradec dhe Ndermarrjet në varësi të Bashkisë Pogradec.

7. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

8. U shpall sot më datë _____.____. 2023.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

